



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3734/14 prot.

Datë 03.06.2026

V E N D I M

Nr. 751 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.137/2026, datë 26.01.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, Nr. REF-72922-12-18-2025, me objekt: *Blerje Kancelari për nevojat e Bashkisë Vorë*, dhe me fond limit 3,333,333 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G. *Adresa: Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/I, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vorë.
Adresa: Rr. Unaza, Nr.2, Vorë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me vendimin Nr. 178/2026 datë 02.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mos lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-72922-12-18-2025, me objekt: Blerje Kancelari për nevojat e Bashkisë Vorë, dhe me fond limit 3,333,333 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

2. Autoriteti Kontraktor të modifikojë dokumentet sipas konstatimeve të Vendimeve të KPP-së në lidhje me procedurën objekt shqyrtimi.

3. Autoriteti kontraktor të përcjellë pranë KPP-së Setin e ri të DST me të gjitha modifikimet në zbatim të Vendimit Nr. 137/2026 datë 26.01.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 3160 Prot., datë 29.05.2026, protokolluar me tonën nr. 3734/11 prot., datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për modifikime të procedurës së prokurimit sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën ardhur me nr. 3160 Prot., datë 29.05.2026, protokolluar me tonën nr. 3734/11 prot., datë 01.06.2026, autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për modifikime të procedurës së prokurimit sipërcituar

Referuar shkresës së mësipërme, dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktor ka përcjellë Setin e ri të DST, me modifikimet e kryera për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Komisioni, mori në shqyrtim Setin e DST-së dhe konstatoi se autoriteti ka modifikuar kriteret për kualifikim, në zbatim të vendimit të KPP-së.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor Bashkia Vorë ka zbatuar vendimet me Nr.137/2026, datë 26.01.2026 dhe Nr. 178/2026 datë 02.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-72922-12-18-2025, me objekt: Blerje Kancelari për nevojat e Bashkisë Vorë, dhe me fond limit 3,333,333 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë..
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro